REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
Sheshi "Liria" , tel & fax +355 52 2/223 10e-mail:info@Durres.gov.al

Open Procurement Albania

RELACION DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

"RIKONSTRUKSIONI RRUGËVE TË BRËNDSHME DHE RIKUALIFIKIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE TEK ZONA E PLAZHIT TE SHKEMBI I KAVAJES, BASHKIA DURRËS"

- ***Venodhja e objektit***

Objekti :" ***RIKONSTRUKSIONI RRUGËVE TË BRËNDSHME DHE RIKUALIFIKIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE TEK ZONA E PLAZHIT TE SHKEMBI I KAVAJES, BASHKIA DURRËS".*** *ndodhet brenda territorit administrativ te Bashkise Durres.*

Zona ne studim ka nje forme te shtire gjatesore veri- jug ne forme jo te rregullt. Zona kufizohet:

Në veri nga "Lumi Durresit"
Në jug nga "Rruga Butrinti "
Në lindje me Rrugen "SH4"
Në perëndim nga "Deti Adriatik"

ZONA E parashikuar per studim-projektim, sipas detyres se Projektimit ka një sipërfaqe prej 39 ha.

Ne kete zone dominojnë ndërtimet e pas viteve 1990, objekte banimi dhe sherbimi nga 1 – 12 kate . Zona nga pikepamja urbane ka nje sistem te rregullt ne pjesen jugore dhe veriore , ne pjesen qendrore te saj objektet jane te vendosur ne forme te çrregullt . Densiteti i ndertimit eshte i larte dhe hapsirat publike jane te pakta dhe te pa perdorshme . Rrjeti rrugor i bllokut perbehet nga rrugica te ngushta me potencial per tu zgjeruar ne perputhje me kerkesat e zones.

- ***2. Pershkrimi I kushteve te objektit ekzistues***

Objekti :" ***RIKONSTRUKSIONI RRUGËVE TË BRËNDSHME DHE RIKUALIFIKIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE TEK ZONA E PLAZHIT TE SHKEMBI I KAVAJES, BASHKIA DURRËS".***

eshte nje objekt qe mbeshtet pergjithsisht ne rikualifikimin e hapesirave publike dhe rrjetit rrugor duke bere zgjerimin dhe drejtimin e tyre sipas mundesive konkrete.

Rrjeti rrugor ne pjesen me te madhe te kaseve te tij eshte i pa shtuar me asfalt dhe vereheet mungese ne trotuare . ne pjesen veriore disa ngha rruget jane te asfaltuara por kane demtime . pergjat rruges dytsore e cila eshte e vetmja rruge lidhese e zones me qytetin mungoje trotuare , mungoje hapsirat e dedikuara per pozicionimin e kazaneve te mbeturinave (kazanet e mbeturinave jane te vendosur ne krahe te rruges duke perber problem per levizjen e lirshme te automjeteve ne kete aks rrugor) verehet dhe mungese e stacioneve per autobuzet e linjes se transportit publik. Lidhjet ndermjet objekteve te banimit dhe sherbimit jane te zene me depozita te ujit te pishem dhe eshte pothuajse e pa mundur kalimi , verehet nje mungese e hapsirave te rekreacionit , hapsirat publike nuk jane te pershtatshme per tu perdorur nga banoret dhe as nga turistet ne pjesen me te madhe te hapsirave publike ato jane te shtruara me nje shtrese cakell e cila eshte nje burim pluhuri dhe ndotje per ajrin .
Koeficienti i shfrytezimit ne zone eshte ne masen 35% por eshte e shperndare ne zonen veriore dhe qendrore kooeficienti eshet me i larte gjithashtu densiteti i ndertimit eshte i lart .

Open Procurement Albania

Pamje te gjendjes ekzistuese

Pamje te gjendjes ekzistuese

Procurement Albania

Pamje te gjendjes ekzistuese

Procurement Albania

Pamje te gjendjes ekzistuese

Procurement Albania

Procurement Albania

Pamje te gjendjes ekzistuese

3. Pershkrimi I punimeve/nderhyrjeve te reja ne objektin ekzistues

Rikualifikimi i hapsirave publike dhe i rrjetit rrugore duke plotesuar me trotuare ne pjeset e munguara 33500 m^2 asfaltim dhe 22000 m^2 trotuare, shtimi i siperfaqeve te gjelberta duke e plotesuar me gjeberim te ulet dhe te larte te cilat do te ndihmojne se tepermi ne permiresimin e cilesise se ajrit ndricimi i rrjetit rrugor dhe i hapsirave publike per te mundesuar nje perdorim edhe gjat mbremjes dhe plotesimi e peisazhit turistik te zones , krijimi i hapsira per rekreacion te cilat duhet te jene te pajisura me stola dhe me kende lojrash per femije.

Eshte e nevojshme krijimi i hapsirave te pershtatshme per te jetuar dhe pushuar.

pajisja me sinjalistiken e nevojshme .

4. Cilat jane problemet qe adreson ky projekt.

Problemet që adreson ky project kanë të bëjnë në plotësimin me funksionet e munguara në sherbim dhe infrastructur. Zgjerimi dhe sistemimi i hapesirave ekzistuese publike ,krijimi I hapsirave rekreative plotesimi me mobilim urban dhe ndricim. Projekti konsiston ne rikualifikimin e zonave turistilke si zona me potencial dhe me një ndikimim të lart ne turizem dhe per rrjedhojë në ekonominë locale.

5. Risqet per zbatimin e tij.

Projekti nuk paraqet risqe per zbatimin e tij . i vetmi risk i mundshem eshte afati i punimeve.

6. Informacion per pronesine e tokes.

Porjekti konsiston ne riabilitimin e rrugeve dhe hapesirave ekzistuese qe te aksesojne ne det si rrjedhoj nevojat per nderhyrje ne prona private jane shume te vogla dhe minimale . per kete pjese po bashkpunojme me zyren e ZRPP durres

Nje paraqitje e pergjithshme e pozicionit gjeografik e objektit

"Rikualifikimi i hapesirave publike dhe rrjetit rrugor".

Open Procurement Albania

jepet ne vizatimin e horografise bashkalidhur.



Qellimi

- *Hapsirat publike (si peisazhe te kuruar)jane magnete te fuqishem turistik elementet e dizainit urban kan treguar se jan bere terheqje shume te forta turistike, gjithashtu jane motorre shume te rendesishem ekonomike sepse nje zone me vemendje te larte turistike. Krijone mundesi te reja per punesim. Turizmi bregdetar eshte nje pike shume e fuqishme ne kuadrin ekonomik dhe per rrjedhoje sa me atraktiv dhe i kompletuar ne sherbime aq me i sukseshem do te jete ne terheqen e turisteve jo vetem nga rajoni por dhe me gjere,.benefite te cilat sjellin nje zhvillim te ekonomise .*

- ***Konservim (…** i hapesirave te mbetura**)***
- ***Kërkim (…** i menyrave te reja per ti ofruar qytetareve dhe turisteve nje peisazh relaksues**)***
- ***Shtrirje turistike në zonë (…** promovim i potencialeve perthithese te brigjeve shqiptare**)***
- ***Mundësi punësimi (…** inkurajon nje sere aktivitetesh tematike te nderlikuara qe do te conin perpara punesimin dhe ekonomine shume me teper sesa thjesht punesim**)***
- ***Argëtim***
- ***Frymë e re arkitektonike***

- Objektivat e ketij projekti jane të siguroj një facilitet argëtues/edukativ në zone, aktiv gjatë 12 muajve të vitit.
- Të qëndrojë në harmoni me natyrën, të jetë bashkëveprues (formës, materialeve)
- Të sigurojë një hyrje e cila do të thithë vizitorët drejt një zone ku secili te shijoj peisazhin dhe qetesine e detit.
- Plotësimin me funksionet e munguara në sherbim dhe infrastructur
- Zgjerimi dhe sistemimi i hapesirave ekzistuese publike.
- Rikthim i vizitorit

Open Procurement Albania



Qyteti I Durrësit ndodhet midis Koordinatave 41° 18’ 40’’ gjerësi gjeografike veriore deri në 19° 26’ 21’’ gjatësi gjeografike lindore.
Sipërfaqje 1626 ha.
Gjatësia e përgjithshme e vijës kufitare është 121.3 km, nga ku 61.8 km janë detarë.
Në pjesën perëndimore laget nga deti Adriatik, duke pasur një vijë bregdetare të thyer.

Procurement Albania

plani i pergjithshem ne te cilen jane paraqitur te gjithe elemntet e rikualifikimit te zones e trotuare hapsirat e gjelberta sheshet publike dhe rruget dalese ne det.

Krijimi i një peizazhi të veçantë për "kater stinet e vitit ", do të arrihet duke përdorur tonalitete te njgjyrave perfaqsuese per 4 stinet e vitit

Krijimi i askeve te cilat i bejne te mundur pushueseve dhe banorve te kene nje dalje sa me te thjesht per ne det.akse intuitive te cilet ndihmojne perdoruesit e kesaj zone te jene me komod gjat qendrimit te tyre .

shesht publike jane nje nga elementet me te qendesishem te cilet bejne nje formulim me te qart te bllokut dhe plotoesoje ansamblin e atraksioneve te zone duke krijuar hapsira te cila mund te perdoren gjat dites por dhe ne mbremje si qendra te vogla brenda kesaj zone turistike

infrastruktura ne brendesi te bllokut eshte trajtuar me materiale natyrore te cilet pershtaten me se mire me natyren dhe qendrojne ne harmoni me te ne kete menyre perpiqemi ti ruajm nje identiet zones . veshja me pllaka guri natyror mundeson dhe nje fleksibilitet shume te madh ne rastet kur ka defekt ne rrjetin inxhinierik sepse mund te kryhen punime dhe zonat e prekura mund te kthehen ne gjendjen e meparshme pa u demtuar.shetitorja pergjat plazhite eshte trajtuar nje nje udhetim neper kater stinet e vitit nje shetitje e cila ne cdo ndryshim stine ska nje shesh koncepti I valeve te detit dhe stinet e vitit bejne qe kjo shetitje te jete me afer natyres ne trajte dhe ne forme. Pergjate gjithe shetitores jane vendosur stola te cilet gjithashtu jan trajtuar me te njejtin koncept .

- **GËRMIM DHEU DHE PUNIME PRISHJE.**

Ky zë është parashikuar të kryhet me makineri dhe transport me auto. Pas arritjes në kuotë të behet profilimi dhe rrulim i tabanit ekzistues me rrul vibrues (dinamik). Mbeturinat të largohen me automjet.

- **SHTRESAT RRUGORE**
  - **S**htresë çakulli makinerie.

Çakulli i makinerisw wshtw material me pwrbwrje granulometrike 20~50mm dhe pas hapjes nw objekt bwhet ngjeshja me rrul vibrues. Shtresa e çakëllit ka trashesi 20cm dhe duhet të laget përpara, pastaj të bëhet ngjeshja me rrul. Shtresa duhet të jetë tërësisht e pastër pa përmbajtje dherash apo materiale tw tjera.

  - **S**htresë çakulli mbeturinë kave.

Shtresa e çakullit me mbetuturinë kave duhet të plotësoj keto kushte:

- Indeksi i plasticitetit nuk duhet të kalojë 10
- Nuk duhet të përmbaj grimca me të medha se 2/3 e shtresës në sasi mbi 5%
- Nuk duhet të përmbaj mbi 10% grimca argjilore. Kjo shtresë duhet të miratohet nga inxhinieri mbas kontrollit të kasonetës. Ngjeshja me 1 kalim do të jetë 150 mm.
- Sipërfaqa e përfunduar e ngjeshur nuk duhet të kaloj ± 20 mm.

  - **S**htresë stabilizanti.

Ky material është gurë i thyer fraktoje me granulometrinë 05~20mm. Shtresa ka trashësinë 10cm dhe ngjeshet me rrul vibrues dhe laget me ujë për të fituar ngjeshmëri maksimale. Lagija me ujë e kësaj shtrese do të vazhdojë edhe pas ngjeshjes, për të mos ndotur zonën me pluhur.

Open Procurement Albania

  - **S**hrese binderi dhe asfalti

Në këtë zë është parashikur spërkatja me bitum 1~2litra/m², transporti, shtrimi me makineri dhe ngjeshja me rrul. Shtresa e binderit të këtë trashësine pas rrulimit 6cm. Materialet e prodhimit të jënë brënda standarteve. Provat merren per çdo 500m² asfalt të shtruar me mostra 25x25 dhe provohen në laborator për treguesit fiziko-mekanik të cilat duhet të jenë brenda kërkesave të STASH 660-87.
Gjatë zbatimit në shtrimin e shtresave asfaltike të kihen parasysh kërkesat teknike dhe të mbahen akt kontrollet teknike ku të pasqyrohen të gjitha të dhënat nga pamja, matjet laboratike, pastërtia e nënshtresave dhe spërkatja me bitum. Shtresa e asfaltit të këtë trashësinë pas ngjeshjes 4cm dhe e binderit 6cm.

- **KANALIZIMET**

Kolektorët KUB në rrugë dhe përgjatë shëtitores do të jenë me dimensione Ø800, Ø630, Ø500, Ø400, Ø 315, Ø250 polietilen PE. Para se të vendosen tubacionet, në kanalin e hapur nën tuba do të hidhet rërë per nivelimin e tubit, dhe mbi tuba do të hidhet shtresë zhavori, pastaj çakëll makinerie, të cilat do të ngjishen me tokmak. Pusetat e reja të kontrollit do të jenë të dimensioneve 1.5x1.5x1.5 për tubacionet Ø500, Ø400, Ø 315 dhe 2.0x2.0x2.0 për tubacionet Ø800, Ø630. Në kunetat ansorë të rrugeve do të vendosen puseta shimbledhese me dimensione 40x60x1.2. Pusetat dhe shimbledhesat jane prej betoni M- 250 me kapak gize si te treguara ne projekt.

Të gjthë kolektorët e KUB kalojnë në aks të rrugëve dhe lidhja e tyre me shimbledhësat bëhet nëpërmjet pusetave të kontrollit me tub Ø250, si tegohet në vizatim.
Kolektori i ujrave të bardha është i vecuar nga kolektori i ujrave të zeza i cili është realizuar në zone disa vite më patë.
Shakrkimi ujrave të bardha për rrugët Vala e Detit dhe Amfora, si dhe rrugët ndërmjet tyre do të bëhen në kanalin e hapur që ndodhet ne krah të rruges Vala e Detit, në piketen Pk A 15.
Pjesa tjetër e bllokut të parë që përbëhet nga rruget Deti Jon, Brindizi, Posejdon etj, grumbullohen në piketën Pk E8, në fundin e rrugës Danubi. Nga piketa Pk E8 largimi i ujrave të bardha bëhet me tuba betoni keson 1m x1m, si tregohet ne vizatim.
Ne pjesen qendrore te gjithe bllokut e cila eshte dhe pjesa me e ngushte, shkarkimi i ujrave të bardha do të bëhet në 4 pika. Në rrugën Liria 2, me kesone 0.8mx1m, e cila mbledh ujrat nga Hotel Bleart deri në Hotel Viena. Shkarkimi i dytë bëhët pranë "Bly Mirage" në rrugen "Liria 4" me me kesone 0.8mx1m. ky kolektor mbledh ujrat e rrugeve "Liria 3" dhe "Liria 4". Sharkimi tjetër bëhet në rrugën "Liria 5" dhe përmbledh ujrat e territorit rreth kësaj rruge. Largimi i tyre drejt detit bëhet me kesone 1mx1m. Shkarkimi tjetër i takon rrugeve "Liria 6" dhe "Liria 7", të cilat grubullojnë ujrat e zonës nga restorat "Kamelia" deri në "Villa Palma".
Pjesa jugore e zonës në bllokun e fundit do të ketë dy shkarkime. Një në rrugën "Liria 10" e cila do të marri ujrat e bardha të rrugve "Liria 11",10,9 dhe 8. Shkarkimi bëhet me kesone 0.8mx1.0m. Shakrkimi i fundit bëhet në rrugen "Butrinti", shkakim i cili mbledh ujrat e rugëve "Butrinit" e Horizont", shkarkimi në det bëhet me kesone 1m x 1m.

Tubat e PVC-se per Kanalizimet jane llogaritur per ngarkesa te renda, te brinjuar ose HDPE-100 me SDR-41.
Tubat do te furnizohen ne komplet se bashku me bashkuesit dhe shtesa te tjera te nevojshme. Kanalet e tubacioneve, shtratimi dhe mbulimi jane pershkruar ne kapitujt e tjere. Pervec se modifikuar ose shtuar si ketu, te gjitha tubat PVC do te plotesojne standarded kombetare dhe nderkombetare. Cdo tub duhet te kete te shenuar ne te ne menyre permanente te dhenat me poshte:
Daten e prodhimit
Emrin e prodhuesit
Shenimi duhet te jete i trupezuar ne tub ose i shkruar me boje rezistente ndaj ujit.

- **SHTRIMI NE KANAL**

Ne pergjithesi, tubacionet e PVC-se shtrohen ne kanale,ne varesi te kushteve klimatike dhe te tokes ne nje thellesi e cila jepet ne projekt(Ne profilin gjatesor dhe terhor)
Karakteristikat gjelogjike te tokes dhe ngarkesa e trafikut ndikojne ne dimensionet e kanalit te tubit dhe ndikojne gjithashtu ne kapacitetin e ngarkeses qe mban tubi vete.
Gjeresia e tabanit te kanalit, kushtezohet nga diametri i jashtem i tubacionit si dhe nga domosdoshmeria e krijimit te nje hapesire pune te dystuar (hapesira minimale e punes). Duke ju permbajtur te dhenave te siperpermendura te gjatesise h dhe gjeresise,

fundi i gropes duhet te krijoje kushtet optimale, qe linja te mbivendoset ne te gjithe gjatesine e saj. Mbishtresezimet duhet te ndahen mundesisht ne menyre te barabarte, duke eliminuar keshtu presionin e ushtruar prej tyre.
Tabani i kanalit nuk duhet te jete i shkriftezuar. Nese ky taban eshte i shkriftezuar, atehere duhet qe perpara vendosjes, ai te dystohet, shtypet ose te mbulohet me nje shtrese te posaçme. Edhe siperfaqet e shkriftezuara, por jo te forta duhet te ngjeshen.
Neqoftese kemi te bejme me siperfaqe shkembore ose gurore duhet qe fundi i kanalizimit te ngrihet te pakten 0.15 m dhe siperfaqja te mbulohet me nje shtrese pa gure (shih Projektin). Kesaj mund ti shtrohet rere, zhavorr i imet ose toke e paster dhe masa e krijuar ngjeshet.
Thellesia minimale e shtrimit zakonisht diktohet nga intersektimet me tubacioneve komunale ekzistuese (te ujit te rjetit Elektrik,telefonik,te ujrave te shiut etj). Ne rruget me trafik te rende nuk rekomandohet qe tubat te shtrohen me mbulim me te vogel se 1.0 m. Ne raste te tilla mund te propozohet nje veshje me beton.
Thellesia e lejuar e hapjes se seksionit te kanalit jepet ne projekt.
Duhet bere kujdes qe fundi i kanalit ku do te shtrohen tubat te jete i rrafshet, pa gure dhe mjaft i forte. Ne qofte se ne germimin me eskavator kjo nuk sigurohet, atehere 20 cm-at e fundit duhen germuar me krah.
Kerkesat e me poshtme jane baze dhe duhen marre parasysh nese duam te shtrijme tubat PVC ne perputhje me standartet;

- perdorimi i nje stafi te specializuar
- pajisja e mjaftueshme me mjete adekuate shtresuese
- mbikqyrje e vazhdueshme
- pranim i rregullt deri ne testin e sterilizimit
- perpilimi i dokumentacionit teknik/azhornimi

Vetem nese ka perputhje me keto kerkesa baze tubacioni i instaluar do te funksionoje ne menyre perfekte per aq kohe sa eshte parashikuar.

- **Mjetet shtruese te tubacionit dhe perdorimi i sakte i tyre**

Mjetet e permendura me poshte duhet te jene ne nje numer te mjaftueshem ne kantier
Veglat TYTON, lubrifikante, mjete preres
Vegla TYTON perdoret per pastrimin e gotave, dhe kontrollimin per mbeshtetjen si duhet te gomines TYTON pas gotes.
Lubrifikant per TYTON dhe lidhje standarte
Mjete preres
Per prerjen e tubave prej PVC-je, disqe abrazive preres jane pare si me te pershtatshmit.
Preres me gur zmeril dhe flete sharre mund te perdoren

- **Instruksionet e montimit**

Hapat qe duhen bere perpara montimit:

Futni gominen brenda ne gote ne menyre te tille qe pjesa e forte e gomines te qendroje e mbeshtetur ne menyre te qendrueshme. Shtypeni gominen mire derisa te bindeni qe eshte pershtatur plotesisht.
Vendosja e gomines mund te lehtesohet nepermjet shtypjes se saj ne dy pika dhe duke e shtypur me pas ne te dy anet. Kufiri i brendshem mbrojtes nuk duhet te dale nga pjesa mbrojtese e gotes.
Kujdes ne transportimin dhe levizjen e tubave, sepse mund te shkaktohen plasaritje te padukshme.
Tubat prodhohen ne gjatesi 6.0m (mund tr behen eshe porosi te veçanta). Mund te priten kudo, midis bordurave, me sharra te zakonshme druri (dore ose mekanike, por jo me sharre zinxhir). Buza e prerjes pastrohet me lime druri ose vegla te tjera ferruese.
Shtrimi fillon nga pika me e ulet. Kupa eshte mire te vihet ne drejtimin ngjites (Siper). Buza e tubit dhe kupes duhen pastruar me kujdes. Mbas kesaj guarnicioni special gome vendoset ne thellimin e dyte midis bordurave (numruar nga buza e gypit. Duhet kontrolluar qe guarnicioni te kete zene vend mire ne thellim dhe te mos jete perdredhur.
Mbas kesaj siperfaqja e brendeshme e kupes lyhet me sapun ose me lendet e tjera te zakonshme, mandej tubi shtyhet brenda kupes me veglat e zakonshme, derisa te takoje. Nuk duhet terhequr mbrapsht fundi i tubit..

- **Mbajtja dhe transportimi i tubave ne zone**

Tubat PVC do te mbahen me kujdes gjate gjithe kohes se prodhimit, transportimit ne vendin e punes dhe instalimit. Çdo tub do te inspektohet ne menyre te kujdesshme sipas standarteve te kerkesave te specifikimit gjate dorezimit dhe perpara se te shtrihen. Asnje tub i krisur, i thyer apo me difekt nuk do te perdoret ne veper. Demtimi i pjeses fundore te tubave qe sipas Mbikqyresit te Punimeve mund te shkaktoje lidhje difektoze, do te jete shkak i mjaftueshem per te hequr tubat e demtuar.
Tubat do te pastrohen plotesisht nga mbeturinat me brendesi perpara se te instalohen dhe do te mbahen te paster ne pergjegjesine e Sipermarresit deri ne marrjen ne dorezim te punimeve. Te gjitha kontaktet siperfaqsore te bashkimevedo te mbahen te pastra deri sa te kete perfunduar bashkimi, Do te merren masa per ndalimin e futjes se materialeve te huaja ne brendesi te tubave gjate instalimit. Ne tuba nuk do te vendosen, mbetje, vegla pune, rroba ose materiale te tjera.

- **SHTRESAT E TROTUAREVE**

Pas germimit dhe arritjes se kuotes behet shtrimi i shtresave te trotuarit.
Shtresa e çakwllit tw makinerisw dhe stabilizanti do tw jenw tw njwjtw pwr nga cilwsia dhe trajtimi me shtreswn e çakwllit e stabilizantit tw rruges (pra lagia dhe ngjeshja me rrul). Kujdes tw tregohet nw ngjeshjen e shtresave pranw bordures se trotuarit. Pllakat do tw jenw vetshtrwnguese me trashwsi 6cm ngjyra dhe forma e tyre do vendosen nw bashkwpunim me projektuesit,. Pllaka duhet tw prodhohet me inerte tw fraksionuara me garnulometri 0-8 mm.

- **NDRICIMI RRUGOR**

Ndricimi ne kete investim do te kete dy funksione, edhe si pjese e arredimit ashtu dhe ane funksionale.

Ne kete investim do te instalohen dy tipe ndricuesish .

Ne kuartalle do te kemi 173Shtylla TIP 1 me dy krahe 6dhe dhe 4m.

Linja kryesore e furnizimit te shtyllave do te jete 4 x 6 mm2 e future ne tubin fleksibel me dy shtersa d=63 mm ne nje kanal 40cm te thell dhe percjellesin e tokezimit qe do te vendoset ne toke paralel me tubin. Ndersa cdo ndricues do te kete percjellesa 3x(1x2.5)mm2.

Cdo shtylle do te kete puseten e tij me kapak te fort plastik me permasa 40 x40 x 40 . Puseta do te betonohet para shtylles. Bazamenti i instalimit te shtylles do te jete nje trup i vetem me puseten 40x40x40 dhe do te behet me beton te markes 200 (shih detajin e montimit te shtylles).

Shtyllat do te tokezohen nepermjet percjellesve te tokezimit me seksion 1x35mm2 te cilet do te lidhen me elektrodat e tokezimit me gjatesi 1.5 m dhe permasa 50x50x5 te ngulura ne toke ne thellesine 0.5m. Pecjellesi . tokezimit do te lidhet ne morseterine e jashtme te shtylles ne larteine 10cm mbi nivelin e rruges. Ndersa percjellese qe do te siguroj vijueshmerine e rretit te tokezimit me seksion 1x16mm2 do te lidhet ne morseterine e trupit te shtyles qe ndodhet brenda zgavres se siperme. Elektrodat e tokezimit do te instalohen cdo 3 shtylla. Lidhja e elementeve te tokezimit duhet te siguroje nje vijueshmiri pergjat gjithe linjes, ne menyre qe te siguroj nje mbrojtje me te mire nga kontaktet direkte. Bashke me shtyllen duhet treguar kujdes dhe me tokezimin e elementeve te tjere te shtyllesi si kapaku i morseterise dhe ndricuesi.Gjithashtu te tregohet kujdes me efektin e osidimit, cdo pike lidhje te pastrohet me kujdes deri sa siperfaqa e kontaktit te mos kete papasterita.

Do te kemi 2 panel per komandimin e gjithe ndricimit. Nga paneli nr.1 dhe nr.2 i komandimit do te dalin:
Nga paneli 1 do te dalin tre linja ndricimi perkatesisht L1,L2 ,L3 Sipas planimetrise pjese e projektit.

Nga paneli nr.2 do te dalin dy linja furnizimi. L1,L2

Pra siksioni minimal i perciellsit te tokezimit do te jete:
Per percielles te izoluar 16 mm2

Linjat elektrike duhet te sinjalizohen per prezencen e tyre me an ate shiritave sinjalizuaes qe do te vendosen 20cm mbi nivelin e tubave.

Mbrojtja e percjellesve nga rrymat e larta dhe rrymat e lidhjeve te shkurtra
Te gjitha linjat elektrike te per tu mbrojtur nga mbingarkesat do te mbrohen me automat te paisur me element magneto-termik.

Kabllot e furnizimit me energji

Kabllot dhe percjasat duhet te jene prje bakri dhe te izoluar me veshje PVC ose EPR me tension izolacioni minimum 450/750V simbas normave CEI 20-35 & CEI 20-22II te pershtatshem per instalime ne tuba.
Percjellsat dhe izolacionet e tyre duhet te jene ne gjendje te suportojne temperature 90°C ne rate normale dhe 250°C per kohe te shkurter ne raste avarie. Izolacioni kabllove duhet te jete i perbere nga materjale qe nuk ndimojne perhapjen e flakeve dhe gazeve toksik sipas CEI 20-35 & CEI 20-22 gjithashtu te kenaq dhe rezistencen ndaj goditjeve mekanike sipas CEI 20-11 e 20-34 te peshtatshem per intalime nen toke.

Kuadri I komandimit

Duhet te jete I realizuar conform normave dhe standarteve europiane EN 60529,EN50102 dhe EN 60950 me nje porte me llamarine inoksi me spesore materiali 5mm, tavani , dyshemeja dhe fletet anesore te kuadri te kene spesor 3mm i gjithe kuadri te jete i lyer me boje puder resistente ndaj temperaturave te larta dhe ngjyra te jete gri RAL 7035.
Kuadri do te jete i pershtatshem per 24 njesi, me permase 800x600x200. Kuadri do te jete i kompletuar me automatet mbrojtes ndaj mbingarkesave dhe lidhjeve te shkurtra. Relene fotometrike dhe te kete vend per pozicionimin e matjes qe do te vendoset nga ana e OSHEE.
Gjithashtu paneli i komandimit duhet te kete nje dritare qe te beje te mundur leximin e matjes.
Ne brendesi te paneleve do te instalohen paisjet mbrojtese si automatet, relet diferenciale, relet korpuskulare dhe kontaktoret.
Ku:

- Rele diferenciale bazuar ne nomat CEI 23-18 e CEI 23-42 (EN 61008-1)
- Automatet temiko-magnetik mbrojtes CEI 17-5 (CEI EN 60947) e CEI 23-3

Kuadri do te pozicionohet afer kabines se OSHEE.

Ndricuesit ne shtylla h 6,7ml. Te Tipit TP 1

Open Procurement Albania



Open Procurement Albania

Open Procurement Albania

Shtyll cilindrike , çeliku i zinguar ne te nxehte dhe e lyer me boje elektyrostatikeme shkalle mbrojtjeje IP 65 + Ndricuesi nga ana e rruges jo me te vogel se 60w,5400lm,3000-4500k Ndricuesi nga ana e trotuarit jo me te vogel se 30w,1800lm,3000-4500K IP65. TIPI 1

- Shtylla te kete gjatesine 6ml dhe 4ml me dy ndricues LED njera nga rruga te kete karakteristikat 60w, 3000- 4500K, 5400lm, IP 65 100.000 ore pune
ndricuesi tjeter nga ana e trotuarit 30w, 3000-4500K, 1800lm,IP65

- **PIKETIMI I PUNIMEVE**

Sipërmarrësi, me shpenzimet e tij duhet të bëjë ndërtimin e modinave dhe të piketave siç kërkohet, në përputhje me informacionin bazë të Punëdhënësit, dhe do të jetë pergjegjësi i vetëm për përpikmërinë. Sipërmarrësi do të jetë përgjegjës për të kontrolluar dhe verifikuar informacionin bazë që i është dhënë, dhe në asnjë mënyrë nuk do të lehtësohet nga përgjegjësia e tij nëse një informacion i tillë është i mangët, jo autentik ose jo korrekt. Ai ndërkohë do të jetë subjekti që do të kontrollohet dhe rishikohet nga Punëdhënësi, dhe në asnjë rast nuk i jepet e drejta të bëjë ndryshime në vizatimet e kontratës, për asnjë lloj kompensimi për korrigjimet e gabimeve ose të mangësive. Sipërmarrësi do të furnizojë dhe mirëmbajë me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale të tjera të tilla dhe të japë asistenca nëpërmjet një stafi të kualifikuar siç mund të kërkohet nga Punëdhënësi për kontrollin e modinave dhe piketave.

Sipërmarrësi do të ruajë të gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, të bëra ose të vendosura gjatë punës, të mbulojë koston e rivendosjes së tyre nëse ato dëmtohen dhe të mbulojë të gjitha shpenzimet për ndreqjen e punës së bërë jo mirë për shkak të mosmirëmbajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim të këtyre pikave të vendosura, modinave dhe piketave.

Përpara çdo aktiviteti ndërtimor, Sipërmarrësi do të ketë linjat e furnizimit me ujë dhe energji elektrike të vendosura në terren, të drejtën e kalimit të qartë dhe të sheshuar, gati për fillimin e punimeve. Çdo punë e bërë jashtë akseve, kuotave dhe kufijve të treguara në vizatime ose të mosmiratuara nga Punëdhenësi nuk do të paguhet, dhe Sipërmarrësi do të mbulojë me shpenzimet e tij gërmimet shtesë gjithmonë nën drejtimin e Mbikqyrësit të Punimeve.

Open Procurement Albania

- **FOTOGRAFITË E SHESHIT TË NDËRTIMIT**

Sipërmarrësi duhet të bëjë fotografi me ngjyra sipas udhëzimeve të Mbikëqyrësit të Punimeve në vendet e punës për të demostruar kushtet e sheshit përpara fillimit, progresin gjatë punës së ndërtimit dhe mbas përfundimit të punimeve. Nuk do të bëhen pagesa për fotografimin e kantierit të punimeve pasi këto shpenzime janë parashikuar të mbulohen nën koston administartive të Sipërmarrësit.

- **BASHKËPUNIMI NË ZONË**

Ndërtimi do të bëhet në zona të kufizuara. Sipërmarrësi duhet të ketë veçanërisht kujdes në:

a) nevojën për të mirëmbajtur shërbimet ekzistuese dhe mundësitë e kalimit për banorët dhe tregëtarët që janë në zonë, gjatë periudhës së ndërtimit.

b) prezencën e mundëshme të kontraktorëve të tjerë në zonë me të cilët do të koordinohet puna

E gjithë puna, do të bëhet në një mënyre të tillë, që të lejojë hyrjen dhe përballimin e të gjithë pajisjeve të mundëshme për ndonjë Kontraktor tjetër dhe punëtorëve të tij, stafin e Punëdhënësit si edhe të çdo punonjësi që mund të punësohet në zbatim dhe, ose punimet në zonë ose pranë saj, për çdo objekt që ka lidhje me Kontratën ose çdo gjë tjetër.

Në pregatitjen e programit te tij të punës, Sipërmarrësi gjatë gjithë kohës do të bëjë llogari të plotë dhe do të kooperojë me programin e punës se Kontraktorëve të tjerë, në mënyrë që të shkaktojë një minimum interference me ta dhe me publikun.

- **DHERAT**

Gërmimi në dhera duhet të aplikohet në të gjitha materialet që mund të gërmohen si me krahë, (përfshi me kazma) ashtu dhe me makineri.

- **MATERIALE TË PËRSHTATSHME**

Materialet e përshtatshme do të përfshijnë të gjitha materialet që janë të pranueshme në përputhje me kontratën e përdorimit në punimet dhe që janë në gjendje të ngjeshen në një mënyrë të specifikuar për të formuar mbushje ose trase.

- **GËRMIMI**

Gërmimi duhet të kryhet në përputhje me nivelet dhe vijën e prerjeve siç tregohet në Vizatime. Çdo thellësi më të madhe të gërmuar nën nivelin e formacionit, brenda tolerancës së lejuar, duhet të bëhet mirë me mbushje me materiale të pranueshme me karakteristika të ngjashme nga Sipërmarrësi me shpenzimet e tij.
Kujdes i veçantë duhet të ushtrohet kur gërmohen prerje për të mos hequr material përtej vijës së specifikuar të prerjes dhe më pas duke shkaktuar rrezikshmëri për qëndrueshmërine strukturore të pjerrësisë ose duke shkaktuar erozion ose disintegrimin e pjesëve të ngjeshura.
Përmasat e prerjeve duhet të jenë në përputhje me detajet e seksione tërthore tip siç tregohen në Vizatime.

Open Procurement Albania

- **Trajtimi/Ngjeshja e Zonave të Gërmuara**

Zonat dhe pjerrësitë e prerjeve duhet të jenë konform me Vizatimet dhe duhet të rregullohen sipas një vije të pastër të standartit, për një tip të dhëne materiali.
Të gjitha zonat horizontale të gërmuara, duhet të ngjeshen me një minimum dendësie të thatë prej 95% për dhera të shkrifët dhe 90% për dhera të lidhur.

a) Kanalet do të gërmohen në dimensionet dhe nivelin e treguar në vizatime dhe /ose në përputhje me instruksionet me shkrim të Mbikëqyrësit të Punimeve. Zëri i treguar në tabelën e Volumeve (Preventiv) lidhur me gërmimet ,siç është largimi i materialit të gërmuar, etj. do të përfshijë çdo lloj kategorie dheu, nëse nuk do të jetë specifikuar ndryshe. Gërmimi me krahë është gjithashtu i nevojshëm në afërsi të intersektimeve të infrastrukturave të tjera për të parandaluar dëmtimin e tyre. Me përjashtim të vendeve të përmendura më sipër , mund të përdoren makineritë.

b) Nëse nuk urdhërohet apo lejohet ndryshe nga Mbikëqyrësi i Punimeve nuk duhet të hapen më shumë se 30 metra kanal përpara përfundimit të shtrirjes së tubacionit në këtë pjesë kanali. Gjerësia dhe thellësia e kanaleve të tubacioneve do të jetë siç është përcaktuar në vizatimet e kontratës, ose siç do të udhëzohet nga Mbikëqyrësi i Punimeve.

c) Thellimet për pjesët lidhëse do të gërmohen me dorë mbasi fundi i kanalit të jetë niveluar. Përveçse kur kërkohet ndryshe, kanalet për tubacionet do të gërmohen

nën nivelin e pjesës së poshtme të tubacionit si tregohet në vizatime, për të bërë të mundur realizimin e shtratit të tubacioneve me material të granuluar.

Largimi i ujërave nga punimet e gërmimit

Si pjesë e punës në zërat e gërmimit dhe jo me kosto plus për Punëdhënësin, Sipërmarrësi do të ndërtojë të gjitha drenazhimet dhe do të realizoje kullimin me kanale kulluese, me pompim ose me kova si edhe të gjithë punët e tjera të nevojshme për të mbajtur pjesën e gërmuar të pastër nga ujërat e zeza dhe nga ujëra të jashme gjatë avancimit të punës dhe deri sa puna e përfunduar të jetë e siguruar nga dëmtimet. Sipërmarrësi duhet të sigurojë të gjitha pajisjet e pompimit për punimet e tharjes së ujit si edhe personelin operativ, energjinë e të tjera, dhe të gjitha këto pa kosto shtesë për Punëdhënësin. I gjithë uji i pompuar ose i drenazhuar nga vepra duhet të hiqet në një mënyrë të aprovueshme prej Mbikqyrësit të Punimeve. Duhet të merren masa paraprake të nevojshme kundër përmbytjeve.

Përshkrimi i çmimit njësi për gërmimet

Çmimi njësi i zërave të punës për gërmimet do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen për gërmime në të gjithë gjerësinë dhe thellësinë, me çdo mjet që të jetë i nevojshëm, duke përfshirë gërmime me dorë, nën apo mbi nivelin e ujrave nëntoksore, ose nivelin e ujrave sipërfaqsore, përfshirë përzierje dheu të çdo lloji, mbështetëset, përforcimin në të gjitha thellësitë dhe gjeresitë, me çdo lloj mjeti që të jetë nevoja, përfshirë edhe gërmimet me dorë, dhe do të përfshijë largimin e ujrave nëntokësor dhe sipërfaqësor në çdo sasi dhe nga çdo thellësi, me cdo mjet të nevojshëm, do të përfshijë nivelimin, sheshimin, ngjeshjen e formacioneve, provën dhe për çdo pune shtesë për mbrojtjen e formacioneve përpara çdo inspektimi, siç specifikohet, largimin dhe grumbullimin e pemëve të larguara, rilevimi topografik i kërkuar, vendosja e piketave të përhershme, dhe të atyre të përkohëshme, realizimi i matjeve, sigurimi i instrumentave për tu përdorur nga Mbikëqyrësi i Punimeve, furnizimi dhe transporti i fuqisë punëtore, mbajtja e vendit të punës pastër dhe në kushte higjeno-sanitare, dhe çdo nevojë aksidentale e nevojshme për realizimin e Punimeve brenda periudhës së Kontratës dhe pëlqimit të Mbikëqyrësit të Punimeve.
Aty ku materiali i gërmuar është përdorur për mbushje; depozitimi duke përfshirë dhe transportin në dhe nga depozitimi, ngarkimin, shkarkimin, transportin me dorë, janë përfshirë në çmimin njësi për gërmimet.

Kostoja e transportimit të materialit të tepërt të gërmuar deri në vendin e hedhjes, të aprovuar nga Mbikqyrësi i Punimeve, nuk përfshihet në çmimin njësi të gërmimit. Kosto e transportimit të materialit të tepërt ne vendin e hedhjes mbulohet nën çmimin njësi të transportit të materialeve.

- **Gjendja**

Kjo shtresë duhet të ndërtohet vetëm me kusht që shtresa që shtrihet poshtë saj (subgradë ose tabani) të aprovohet nga Mbikëqyrësit të Punimeve. Menjëherë para vendosjes së materialit, shtresa subgradë (tabani) duhet të kontrollohet për dëmtime ose mangësi që duhen riparuar mirë.

- **Shpërndarja**

Materiali do të grumbullohet në sasi të mjaftueshme për të siguruar që mbas ngjeshjes, shtresa e ngjeshur do të plotësojë të gjitha kërkesat për trashësinë e shtresës, nivelet, seksionin tërthor dhe densitetin. Asnjë kurriz nuk duhet të formohet kur shtresa të jetë mbaruar përfundimisht.
Shpërndarja do të bëhet me dorë.
Trashësia maksimale e nënshtresës (subbase) e ngjeshur me një kalim (proçes) do të jetë 150 mm.

- **Ngjeshja**

Materiali i nënshtresës (subbase) do të hidhet me dorë deri në trashësinë dhe nivelet e duhura dhe plotësisht i ngjeshur me pajisje të përshtatshme, për të fituar densitetin specifik në tërë shtresën me përmbajtje optimale lagështie të përcaktuar (+ / - 2%).

Shtresa e ngjeshur përfundimisht nuk duhet të ketë sipërfaqe jo të njëtrajtshme, ndarje midis agregatëve fine dhe të ashpër, rrudha ose defekte të tjera.

Tolerancat në Ndërtim
Shtresa nënbazë e përfunduar do të përputhet me toleancat e dimensioneve të dhëna më poshtë:
Nivelet
Sipërfaqja e përfunduar do të jetë brenda kufijve +15mm dhe +25mm nga niveli i caktuar.

Gjerësia
Gjerësia e nënbazës nuk duhet të jetë me e vogël se gjerësia e specifikuar.
Trashësia
Trashësia mesatare e materialit për çdo gjatësi të rrugës matur para dhe pas niveleve, ose nga çpimet e testimeve, nuk duhet të jetë më e vogël se trashësia e specifikuar.

Kërkesat teknike ndaj materialeve përbërës të asfaltobetonit.

a) Bitumi që përdoret për prodhimin e asfaltobetonit si dhe në asfaltimet e tjera me depërtim ose trajtim sipërfaqësor, duhet të plotesojë kërkesat e Stash 660-87 ose të STASH CNR Nr. 1996 "Karakteristika për pranim"

b) Në kohë të nxehtë (verë) keshillohet përdorimi i bitumit me depërtim (penetrim) 80 deri 120 ose me pikë zbutje 45 deri 50°C, ndërsa në pranverë e vjeshtë bitum me depërtim 120 deri 200 ose pikë zbutje 40 deri 45°C.

- Çakëlli, zalli, zalli I thyer dhe granili duhet të plotësojnë kërkesat e STASH 539-87 "Përpunime ndërtimi".

  Rezistenca në shtypje e shkëmbinjve nga të cilët prodhohet me copëtim mekanik çakëlli e granili, duhet të jetë jo më pak se 800kg/cm2. këshillohet q
- Për shtresën përdoruese, rezistenca në shtypje e shkëmbinjve të jetë mbi 1000kg/cm2.

- Zalli i thyer duhet të përmbajë jo më pak se 35% kokrriza të thyera me madhësi mbi 5mm. Sasia e kokrrizave të dobëta (me rezistencë më pak se 800 kg/cm2) nuk duhet të jetë më shumë se 10% në peshë, për kategorinë e parë të asfaltimit dhe jo më shumë

se 15% në peshë për kategorinë e dytë të asfaltimit. Sasia e kokrrizave në formë pete dhe gjilpërë, të mos jetë me shumë se 25% në peshë për shtresën lidhëse (binder).

Rëra për prodhim asfaltobetoni mund të përfitohet nga copëtimi dhe bluarja e shkëmbinjve me rezistencë në shtypje mbi 800 kg/cm2, ose nga lumi dhe në çdo rast, duhet të plotësojë kërkesat e STASH 506-87 "Rëra për punime ndërtimi".
Për përgatitjen e asfaltobetonit ranor, ajo duhet të jetë e trashë me modul mbi 2.4.
Pluhuri mineral që përdoret për prodhim asfaltobetoni, mund të përfitohet nga bluarja e shkëmbinjve gëlqerorë ose pluhur TCC, çimento, etj. Në çdo rast pluhuri mineral duhet të plotësojë kërkesat lidhur me imtësine dhe hidrofilitetin.
Imtësia e pluhurit mineral duhet të jetë e tillë, që të kalojë 100% në sitën me madhësi të vrimave 1.25 mm dhe te kalojë jo më pak se 70% në peshë në sitën 0.074 mm.
Koefiçienti i hidrofilitetit të pluhurit mineral, i cili shpreh aftësinë lidhëse me bitumin të jetë jo më shumë se 1.1

- **Prodhimi dhe transporti i asfaltobetonit**

- Asfaltobetoni pregatitet në fabrika të posaçme, të cilat këshillohet të ngrihen sa më afër depozitave të lëndëve të para dhe vendit të përdorimit të tij. Aftësia prodhuese e fabrikes përcaktohet në varësi nga plani i organizimit të punës së firmës, që zbaton punimet e ndërtimit të rrugës.

- Materialet mbushës te asfaltobetonit siç janë çakëlli, zalli, granili e rëra duhet të depozitohen pranë fabrikës në bokse të veçanta. Para futjes së tyre në përzierës ato duhet të thahen dhe nxehen deri në temperaturën 250°C, pastaj dozohen dhe futen në përzierës.

- Pluhuri mineral duhet të ruhet në depo të mbuluara dhe pa lagështi. Në çastin e dozimit dhe futjes në përzierës, ai duhet të jetë i shkrifët (i patopëzuar) dhe i thatë. Kur përmban lagështi duhet të thahet paraprakisht dhe futet në gjendje të nxehtë në perzierës.

- Bitumi, në prodhimin e asfaltobetonit futet në gjendje të nxehtë, por temperatura e tij nuk duhet të jetë mbi 170°C për ta mbrojtur nga djegia.

  Në fillim futen në perzierës materialet mbushës dhe pluhuri mineral, përzihen sëbashku në gjendje të thatë e të nxehtë, pastaj i shtohet bitumi po në gjendje të nxehtë dhe vazhdon përzierja derisa të krijohet një masë e njëtrajtshme.

- Dozimi i perbërësave të asfaltobetonit duhet të bëhet me saktësi ± 1.5% në peshë për pluhurin mineral dhe bitumin me saktësi ± 3% në peshë për materialet mbushësa të çfarëdo lloji, madhësie.

- Temperatura e masës së asfaltobetonit mbas shkarkimit nga përzierësi duhet të jetë në kufijtë 140 deri 160°C. Kur temperatura e mjedisit të jashtëm është 5 deri në 10°C, kufiri më i ulët i asfaltobetonit do të jetë jo më pak se 150°C.

Open Procurement Albania

- Transporti i asfaltobetonit duhet të bëhet me mjete vetëshkarkuese. Karroceria e tyre para ngarkesës duhet të jetë e pastër, e thatë dhe e lyer me përzieres solari të holluar me vajgur, për të mënjanuar ngjitjen e masës së asfaltobetonit. Këshillohet që karroceria e mjetit të jetë e mbuluar, për të mbrojtur asfaltobetonin nga lagështia dhe te ngadalësojë shpejtësinë e ftohjes së masës gjatë transportit.

- Automjeti që transporton asfaltobeton duhet të shoqërohet me dokumentin e ngarkesës, ku duhet të shënohen: targa e automjetit, lloji dhe sasia e asfaltobetonit, temperatura e masës në nisje dhe koha e nisjes e automjetit me ngarkesë nga fabrika.

- Kontrolli mbi cilesinë e asfaltobetonit bëhet në përputhje me kërkesat e STASH 561-87.

- Mostrat për kontrollin cilësor të prodhimit, nxirren nga 3 deri 4 përzierje gjatë shkarkimit të masës se asfaltobetonit në automjet, duke veçuar 8 deri në 10kg nga çdo përzierje. Sasia e veçuar përzihet deri sa ajo të bëhet e njëtrajtshme dhe prej saj merret mostër mesatare me sasi 10kg. Mbi këtë mostër mesatare kryhen provat në laborator për përcaktimin e treguesave fiziko-mekanike, të cilët krahasohen me kërkesat e projektit ose STASH 660-87 për vlerësimin cilësor të prodhimit.

- Kontrolli mbi cilësinë e prodhimit të asfaltobetonit duhet të kryhet sa herë dyshohet nga pamja gjatë shkarkimit të përzierjes në automjet dhe në çdo rast jo më pak se një herë në turn.

- Kontrolli mbi cilësinë e prodhimit mund të bëhet edhe me metoda praktike duke u nisur nga pamja dhe punueshmëria e masës së asfaltobetonit gjatë vendosjes në vepër siç, janë rastet e mëposhtme:

- Asfaltobetoni që përmban bitum brenda kufirit të lejuar është i butë, shkëlqen dhe ka ngjyrë të zezë. Formon mbi karrocerinë e mjetit një kon të rrafshët dhe nuk fraksionohet gjatë shkarkimit. Kur përmban më shumë bitum, masa shkëlqen shumë, ngarkesa në karrocerinë e mjetit rrafshohet, gjatë shkarkimit bitumi rrjedh nga kokrrizat, bitumi del në sipërfaqe dhe shtresa rrudhoset gjatë ngjeshjes me rul. Kur përmban me pak bitum, masa e asfaltobetonit ka ngjyrë kafe, fraksionohet gjatë shkarkimit dhe kokrrizat e mëdha janë të pambështjella mirë me bitum dhe janë të palidhura me njëra-tjetrën.

- Asfaltobetoni që ka temperaturë brenda kufirit të lejuar (140 - 160°C) lëshon avull në ngjyrë jeshile dhe mjedisi sipër tij ngrohet. Kur temperatura është shumë e lartë, avulli ka ngjyre blu te fortë. Kur temperatura është shumë e ulët, mbi masën e asfaltobetonit të ngarkuar në automjet formohet kore dhe mbas shkarkimit nuk avullon. Nuk realizohet ngjeshja e kërkuar dhe mbi sipërfaqen e shtresës së porsashtruar dallohen kokrrizat të palidhura mirë.

- Asfaltobetoni që përmban granil më shumë se kufiri i lejuar, shkëlqen shumë e fraksionohet gjatë ngarkim shkarkimit dhe në sipërfaqen e shtresës së porsashtruar dallohen zona me kokrriza të palidhura mirë. Kur përmban granil më pak se kufiri i

Open Procurement Albania

lejuar, masa është pa shkëlqim, ka ngjyrë kafe dhe sipërfaqja e shtresës së porsashtruar është shume e lëmuar.

- Kur masa e asfaltobetonit lëshon avull me ngjyrë të bardhë, tregon se tharja në baraban e materialeve mbushës nuk është bërë e plotë dhe ato përmbajnë akoma lagështi.

- Kur vërehen mangësi si ato të përshkruara në paragrafin m (pika m-1; m-2; m-3; dhe m-4) nuk duhet lejuar vazhdimi i punës për shtrimin e asfaltobetonit dhe të njoftohet menjëherë baza e prodhimit për të bërë korrigjimet e nevojshme në recetën e prodhimit.

- **SHTRIMI DHE NGJESHJA E ASFALTOBETONIT.**

- Ndërtimi i mbulesës rrugore fillon të kryhet mbasi të kenë përfunduar punimet e themelit (nënshtresës) dhe të jenë treguesit teknik lidhur me ngjeshmërinë ose aftësinë mbajtëse të tyre në përputhje me kërkesat e projektit.

- Tipi i mbulesës rrugore me një ose më shumë shtresa, lloji i asfaltobetonit dhe trashësia e çdo shtrese në veçanti, përcaktohen nga projektuesi në projektin e zbatimit.

- Në ndërtimin e autostradave dhe rrugëve të Kat. I e të II, themeli (nënshtresa) duhet të jetë shtresë asfalti, shtresë makadami ose shtresë çakëlli, të cilat në çdo rast duhet të jenë të percaktuara në projektin e zbatimit.
- Themeli (nënshtresa) mbi të cilën vendosen shtresat e asfaltobetonit, duhet të jetë e thatë dhe e pastër. Koha më e përshtatshme për shtrimin e asfaltobeonit është stina e pranverës, verës dhe vjeshtës. Megjithatë, në ditët me reshje shiu nuk lejohet.
- Shtrimi i asfaltobetonit duhet të fillojë nga njëra anë e rrugës (buzina) e deri në mesin e saj, duke ecur paralel me aksin gjatësor, për një segment rruge të caktuar, e cila zakonisht mund të jetë deri në 60m, më pas vazhdohet në segmentin tjetër e kështu me rradhë.
- Shtrimi i asfaltobetonit, sidomos në shtrimin e autostradave dhe rrugët e Kat. I e të II duhet të bëhet me makina asfaltoshtruese, të cilat sigurojnë shpërndarje të njëtrajtshme të masës së asfaltobetonit. Shpejtësia e lëvizjes së makinës asfaltoshtruese duhet të jetë 2 deri 2.5 km/orë.
- Trashësia e shtresës së asfaltobetonit në momentin e shtrimit (në gjendje të shkrifët) duhet të jetë 1.20 deri 1.25% më shumë nga trashësia e dhënë në projektzbatim në gjendje të ngjeshur.
- Temperatura e masës së asfaltobetonit në momentin e shtrimit në rrugë duhet të jetë në kufijtë 130 deri 150°C. Në kohë të nxehte jo më pak se 130°C dhe në kohë të ftohtë (kur temperatura e mjedisit të jashtëm është 5 deri ne 10°C) të jetë jo më pak se 140°C.
- Ngjeshja e shtresës së asfaltobetonit duhet të kryhet menjëhere mbas shtrimit të tij në rrugë. Cilindri ngjeshës mund të ndjekë nga pas makinerinë asfaltoshtruese duke qëndruar në largësi deri 4m, me qëllim që ngjeshja të kryhet në gjëndje sa më të nxehtë.

Open Procurement Albania

- Ngjeshja e shtresës së asfaltobetonit per gjysmën e parë të rrugës fillon nga buzina (bankina), ndërsa për gjysmën tjetër nga fuga gjatësore, e cila mund të jetë aksi i rrugës.
- Makineritë që përdoren për ngjeshjen e shtresave të asfaltobetonit mund të jenë rula të zakonshëm me pesha të ndryshme nga 5 deri në 12 ton ose rulo me vibrim.
- Kur përdoren për ngjeshje rula të zakonshem, numri i kalimeve luhatet në kufij 12 deri 17, ndërsa kur përdoren rula vibrues, numri i kalimeve ulet ne masen deri 50%.
- Në fillim të ngjeshjes, cilindri në kalimet e para (deri 4 kalime) duhet t'a bëjë në të gjithë sipërfaqen e shtresës së asfaltobetonit duke ecur me shpejtësi 2 deri ne 2.5km/orë. Drejtimi i lëvizjes në kalimet e para këshillohet të bëhet në drejtim të cilindrit të parmë, me qëllim që të mënjanohet rrudhosja e shtresës.
- Në kohë të nxehtë, fillimisht ngjeshja e shtresës së asfaltobetonit bëhet me rulo me peshë të lehtë 5 deri 7 ton dhe më pas vazhdohet me rulo me peshë 10 deri ne 12 ton, ndërsa ne kohë të ftohtë, ngjeshja fillohet me rulo te rëndë 10 – 12 ton dhe më pas vazhdohet me rulo të lehtë, shpejtësia e lëvizjes së rulit duhet të jetë në kufijtë 2 deri 4km/orë.
- Ngjeshja e vendeve që nuk mund të kryhen me cilindër, ngjeshen me tokmak ose pllaka të nxehta.
- Cilindri ngjeshës në çdo kalim duhet të shkele ne gjurmen e mëparshme jo më pak se 0.25 te gjerësise së tij.
- Ngjeshja e asfaltobetonit quhet e përfunduar atëherë kur mbi sipërfaqen e asfaltuar cilindri gjatë kalimit të tij nuk lë më gjurmë.
- Cilindri i rulit gjatë punës për ngjashjen shtresës së asfaltobetonit duhet të lyhet vazhdimisht me solucion solari të holluar me vajgur për të mënjanuar ngjitjen e kokrrizave të bituminuara në të.
- Nuk lejohet që ruli te qëndrojë në shtresën e asfaltobetonit të pangjeshur plotësisht ose të bëjë manovrime të ndryshme mbi të.
- Kur shtrimi i asfaltobetonit kryhet pa ndërprerje dhe përbëhet nga dy shtresa, këshillohet që shtresa e binderit te kryhet natën, ndërsa shtresa përdoruese diten.
- Per të mënjanuar rrudhosjen e shtresave të asfaltobetonit në rrugët, që kanë pjerrësi gjatësore mbi 6% është e domosdoshme që të sigurohet sipërfaqe e ashpër e shtresës së asfaltobetonit duke përdorur për prodhimin e tij çakëll kokërrmadh dhe ngjeshja me cilindër të kryhet duke filluar nga pjesa më e ulët.
- Fugat të cilat krijohen gjatë shtrimit të asfaltobetonit në kohë të ndryshme duhet të trajtohen me kujdes te veçantë, për të mënjanuar boshllëqet që mund të krijohen në to. Këshillohet që të respektohen rregullat që vijojnë:
- v-1) Fugat midis shtresës së binderit dhe shtreses përdoruese të asfaltobetonit duhet që në çdo rast të jenë të larguara nga njëra-tjetra në kufijtë 10 deri 20cm (shih fig 2).
- v-2) Ndërprerjet e shtresës së asfaltobetonit në plan në drejtim tërthor me aksin e rrugës duhet të bëhet me një kënd 70° (shih fig 1).
- v-3) Fugat gjatësore e terthore me aksin e rrugës duhet të bëhen të pjerrëta me 45°. Para fillimit të shtresës pasardhëse të asfaltobetonit, shtresa e mëparshme duhet të pritet me daltë duke e bërë fugën të pjerrët me kënd 45°.
- v-4) Para fillimit të shtresës së asfaltobetonit fuga lyhet me bitum dhe në buzë të saj vendoset listelë druri, e cila kufizon trashësinë e asfaltobetonit të shkrifët dhe nuk lejon asfaltin e fresket mbi shtresën e ngjeshur më parë. Kur fillon ngjeshja hiqet listela dhe cilindri duhet të bëjë ngjeshjen duke shkelur jo më pak se 20cm fugën.

Open Procurement Albania

Mbas perfundimit te ngjeshjes, fuga në të dyja anët e saj në një gjerësi prej 6cm duhet të lyhet me bitum.

- v-5) Në rastet kur shtresa përdoruese e asfaltobetonit shtrohet mbasi shtresa lidhëse (binderi) i është nënshtruar me parë lëvizjeve te automjeteve, duhet detyrimisht të pastrohet sipërfaqja e saj nga papastërtitë e pluhuri, të mos përmbajë lagështi dhe të spërkatet me bitum të lëngshëm (në sasi deri 06 kg/m2) para fillimit të vendosjes së shtresës përdoruese të asfaltobetonit.

- **BETONET**

- **Të përgjithshme**
- Puna e mbuluar nga ky seksion i specifikimeve konsiston në furnizimin e gjithë kantierit, punën, pajisjet, veglat dhe materialet, dhe kryerjen e te gjitha punimeve, në lidhje me hedhjen, kujdesin, përfundimin e punës së betonit dhe hekurin e armimit në përputhje rigoroze me këtë kapitull të specifikimeve dhe projekt zbatimin.
- Në fillim të Kontratës Sipërmarrësi duhet të paraqesë për miratim tek Mbikëqyrësi i Punimeve një njoftim për metodat duke detajuar, në lidhje me kërkesat e këtyre Specifikimeve, propozimet e tij për organizimin e aktiviteteve të betonimit në shesh (terren). Njoftimi i metodave do të përfshijë çështjet e mëposhtme:

- Njësia e prodhimit e propozuar
- Vendosja dhe shtrirja e paisjeve të prodhimit të betonit
- Metodat e propozuara për organizimin e paisjeve të prodhimit të betonit
- Proçedurat e kontrollit të cilësisë së betonit dhe materialeve të betonit
- Transporti dhe hedhja e betonit
- Detaje të punës së bërjes së kallëpeve duke përfshirë kohën e heqjes së kallëpeve dhe proçedurat për mbështetjen e përkohshme të trarëve dhe të soletave.

Open Procurement Albania

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE
TE KONTINERIT PER MBLEDHJEN E MBETURINAVE TE

KAPACITETIT V : 1.1 m3

- Vellimi 1.1 m3
- Gjatesia 1360 mm
- Lartesia 1420 mm
- Gjeresia 1050 mm
- Kapaciteti i plote 1100 litra
- Pesha 148 kg
- Materiali i trupit te kontinerit llamarine e paster d= 1.5 – 1.8 mm
- Mbeshtetsja e kontenjerit me spesor 1.8 -2 mm e lart.

Materiali i baza e mbeshtetjes se rrotes te jete 4.5 mm .

- Lloji i celikut C, 0361 dhe C, 0146 ose me kualitativ
- - Numri i dorezave per ngritje Dy anesore majtas dhe djathtas
- - Materiali i kapakut te kontinerit llamarine e pastruar d= 1.5 mm
- - Forma e kapakut i harkuar me sust, me gome mbi vijen dhe

mekanizmi per pershtatjen.

- -Kapaku te kete mekanizem per hapje me dore, I lehte ne perdorim.

- Sistemi ngrites i pershtatshem per nje mjet teknologjik.Ky sistem do te jete i njejte me sistemin aktual te NKP.
- Ngjyrosja e kapakut me antindryshk,ose te jete plastik.
- Numri i dorezave per hapjen e kapakut dy anash majtas e djathtas
- Numri i rrotave 4 cope.
- Dimensionet e rrotave fi ø 200 mm me gome mishi.
- Aksi i rrotave me kushineta.
- Levzshmeria e rrotave 360 grade.
- Fuqia e mbajtjes se peshes se rrotave 500 kg
- Sistemi i rrotave me mekanizem frenimi te dy rrotave te para.
- Kualiteti i mbrojtjes 99.99% heqja e ndryshkut.
- Lyerja me boje 100% e kapakut,antindryshk.
- Zinkimi i kontinierit 100% e trupit me te gjitha
- Aksesoret.

Kusht;

1. Ne ç'do kazan te jene te vendosur shiritat fosforoshent bardh dhe kuq per te qene te dukshem naten dhe diten.
2. Kontenjeri te kete te stampuar stemen N.K.P DURRES
3. Firma fituese te jete e paisur me certefikate iso 9001.
4. Firma fituese te ka zbatuar dhe mban një sistemet e menaxhimit të mjedisit i cili plotëson kërkesat e standartit ISO 14001.ISO18001
5. Firma fituese te beje dhe transportin e materialeve deri ne destinacionin perkates.
6. Firma fituese te jete e çertifikuar per prodhimin e kontenjerve.
7. Firma fituese te kete punuar mbi prodhimen e ketyre modele kontenjeresh..
8. Materiali te jete sipas specefikimeve te kerkuar nga ndermarrja.
9. Malli do merret ne dorzim vetem ,nese ka perpuethshmeri me kerkesat e kerkuara nga ana e nderrmarrjes.
10. Nese firma fituese eshte subjekt tregetar,duhet te sjell certefikatat ISO .te prodhuesit te shoqerura me kontrate. ISO 9001, ISO 14001.ISO18001.

Open Procurement Albania

Ark. Hysen ÇIFLIKU
Ing. Diana DEDJA
Ark. Adnand TOÇILA
Ing.Bora HYSI
Ing.Eni TURKESHI
Ing.Elk.Mirela STEFANI
Ing.Elk.Mariglen JAHOLLARI